

FAZA E DYTË E PROVIMIT TË PRANIMIT

ÇELËSI I KAZUSIT CIVIL 2

Përgjigjet e pyetjeve të shtruara për diskutim:

1. Kur në objektin e gjykimit ka disa kërtime si të natyrës civile dhe administrative, si zgjidhet çështja e kompetencës lëndore të gjykatës? (10 pikë)

Jurisprudenca e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (KBGjL) në lidhje me këtë çështje është krijuar dhe ndryshuar në një kohë të shkurtër. Koncretisht KBGjL kanë nxjerrë dy vendime unifikuese, fillimisht atë me nr. 4, datë 10.12.2013 e më pas atë me nr. 3, datë 28.4.2014. Në vendimin unifikues nr.4, datë 10.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera u njësuar praktika si më poshtë:

"A. Kur në objektin e gjykimit ka disa kërtime si të natyrës civile dhe administrative dhe këto kërtime konstatohen nga gjykata se janë një bashkim i thjeshtë i tyre, atëherë referuar nenit 61 dhe 159 të K.Pr.Civile dhe 13 dhe 23 të ligjit 49/2012, gjykata duhet të veçojë objektet që nuk janë në kompetencën e saj lëndore duke i kaluar ato gjykatës kompetente.

B. Kur në objektin e gjykimit ka disa kërtime si të natyrës civile dhe administrative dhe këto kërtime konstatohet nga gjykata se janë një bashkim i ndërvuarur mes tyre, atëherë referuar nenit 55 të K.Pr.Civile dhe nenit 24 të ligjit 49/2012 dhe zbatimit të parimit "lex specialis derogat generali", gjykata kompetente është si më poshtë:

- kur në objektin e gjykimit pala paditëse ndër të tjera ka për objekt kundërshtimin e një akti administrativ dhe nga pasojat e aktit prodhohen pasoja civile në çdo rast kompetente është gjykata administrative.
- kur një ndër objektet e gjykimit është një kërkim më natyrë civile, por që është i lidhur ngushtë me aktin administrativ dhe pasojat e këtij akti kanë ardhur nga vullneti shtetëror, atëherë përsëri gjykata kompetente është gjykata administrative.
- kur objektet e tjera të padisë jo të natyrës së mosmarrëveshjes administrative janë të ndërvuarur nga pasojat e aktit administrativ dhe në këtë rast kjo të çon tek kompetenca e gjykatës administrative."

Ndërsa në vendimin unifikues pasues me nr. 3, datë 28.4.2014 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë ndryshuan qëndrimin e tyre të mëparshëm të dhënë për zbatimin e ligjit nr. 49/2012, në paragrafin 46, pikat "A" dhe "B" të vendimit unifikues nr.4, datë 10.12.2013, duke njësuar praktiken gjyqësore si më poshtë vijon:

"Kur në objektin e gjykimit të një çështje ka disa kërtime si të natyrës civile dhe administrative, këto kërtime pavarësisht faktit nëse kanë një lidhje të thjeshtë në mes tyre, apo janë edhe të ndërvuara nga njëra-tjetra, referuar nenit 61 dhe 159 të K.Pr.Civile dhe 13 dhe 23 të ligjit 49/2012, gjykata duhet të veçojë kërkimet që nuk janë në kompetencën e saj lëndore, duke ia kaluar ato gjykatës kompetente."

Për shkak të problematikës që krijohet nga interpretimi i ri njësuës në lidhje me çështjet me disa kërtime civile dhe administrative të gjykuara nga gjykatat para datës 4.11.2013, KBGjL në vendimin e ri nr. 3, datë 28.4.2014, theksuan se pavarësisht se kërkimet [...], të cilat për shkak të ligjit nr. 49/2012 nuk mund të jenë më në kompetencë të gjykatës ku janë paraqitur, në kohën e parashtrimit të tyre, gjykata e cila ka qenë kompetente për marrjen e tyre në shqyrtim dhe në respektim të parimit "perpetuatio fori" do të vazhdojë gjykimin e tyre. Rrjedhimisht Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë njësuar praktiken gjyqësore si vijon:

"Çështjet të cilat në objektin e tyre kanë disa kërtime si të natyrës civile dhe administrative, kërtime të cilat janë paraqitur përpara datës 04.11.2013, do të vazhdojnë të gjykohen nga gjykata ku ato janë paraqitur."

2. Kur në objektin e gjykimit kundërshtohet vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës apo Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kjo çështje do të konsiderohet si mosmarrëveshje administrative dhe do të shqyrtohet nga gjykata administrative apo do të konsiderohet si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohet nga gjykata civile? (10 pikë)

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr.4, datë 10.12.2013 kanë theksuar faktin se pronësia është institut kryesor i së drejtës civile. KBGjL për ti dhënë përgjigje pyetjes së mësipërme kanë mbajtur parasysh edhe praktikën e tyre të mëparshme unifikuese, të krijuar ndër të tjera edhe me vendimin unifikues nr. 24, datë 13.3.2002, në të cilin ato kanë analizuar dhe interpretuar natyrën dhe qëllimin e ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" si dhe nocionin kthim prone të përdorur si në titullin e ligjit ashtu edhe në përmbajtjen e tij. Kolegjet e Bashkuara janë shprehur se ligjvënësi me këto akte të rëndësishme normative ka njohur padrejtësinë, shkeljen e të drejtave të pronësisë ish pronarëve dhe ka vendosur të rinjohë të drejtën e pronësisë së tyre duke ju kthyer pronat e shtetëzuara, të shpronësuara, të konfiskuara apo të marra pa të drejtë në forma të tjera, dhe në pamundësi, duke i kompensuar ato. Këto ligje, duke konsideruar të padrejtë atë që kishte ndodhur më parë, parashikuan kthimin e të drejtave të pronarëve mbi pronën, kur objekt i sajishin sende të paluajtshme. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i kanë konsideruar këto akte ligjore që u drejtoheshin ish pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre, jo si mënyrë të re të fitimit të pronësisë në favor të tyre, por si mjete që mbrojnë dhe garantojnë të drejtën e pronësisë dhe bëjnë efektive atë. Si në titullin e ligjit, ashtu edhe në përmbajtjen e tyre, përdoret nocioni kthim i pronës. Nocionin kthim i pronës ose, me saktë, kthim i sendit objekt i së drejtës së pronësisë, Kodi Civil e përmend në rastin e padisë për kërkimin e sendit (actio rivendicatio), neni 296 e vijues i tij. Në rastin kur pranohet padia e rivendikimit, poseduesi jopronar duhet t'i kthejë sendin paditësit në favor të të cilit është njohur e drejta e pronësisë. Sipas KBGjL praktika gjyqësore, ashtu edhe literatura juridike, në këto raste nuk kanë vënë kurrë në dyshim ekzistencën e së drejtës së pronësisë të pronarit joposëdës mbi sendin objekt të padisë së rivendikimit. Pronari joposëdës nuk ka humbur për asnjë moment titullin e së drejtës së pronësisë, por vetëm posedimin e sendit. Përkisht kjo është arsyeja pse ligji e kthen atë në situatën e mëparshme duke i njohur të drejtën e kthimit edhe të frutave të sendit (restitutio in integrum), dhe kur kjo nuk është e mundur, pranon vetëm kthimin e sendit (restitutio in parte).

Në vendimin unifikues nr. 4, datë: 10.12.2013 KBGjL kanë arsyetuar se në gjykimet me objekt kundërshtim të vendimit të K.K.K.Pronave apo A.K.K.Pronave kemi të bëjmë me të drejta subjektive, edhe pse enti shtetëror publik K.K.K.P. (sot A.K.K.Pronave) shpreh vullnetin e tij nëpërmjet vendimeve të marra pas kërkesës së bërë nga subjektet përkatëse. Vendimet e tyre nuk trajtohen dhe nuk goditen në gjykatë si akte të mirëfillta administrative. Subjekti kërkues në një gjykim të zakonshëm kundërshton vendimin e K.K.K.Pronave apo A.K.K.Pronave dhe kërkon të drejtën e pronës duke paraqitur prova në mbështetje të së drejtës së tij të pronësisë. Në këto gjykime, gjykata zhvillon një gjykim themeli lidhur me titullin e pronësisë duke ndryshuar apo shfuqizuar vendimin e K.K.K.Pronave apo A.K.K.Pronave, si dhe duke zgjidhur në themel këtë konflikt që është një konflikt pronësie, pra i natyrës civile. Për këtë arsye legjislatori e kishte pajisur procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave me garanci në mënyrë që të drejtat e shtetasve të kishin një mbrojtje maksimale në gjykatë.

Mbështetur në arsyet e mësipërme dhe në referencë të praktikës gjyqësore të mëparshme unifikuese dhe të zakonshme të Gjykatës së Lartë, jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në vendimin unifikues nr. 4, datë: 10.12.2013 KBGjL njësuan praktikën gjyqësore si vijon:

Kur në objektin e gjykimit kundërshtohet vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kjo çështje do të konsiderohet si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohet nga gjykata që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve civile.

3. A është i mundur gjykimi i mosmarrëveshjeve të ndryshme në një gjykim të vetëm, kjo e fundit e përcaktuar nga lidhja e objekteve midis tyre? (10 pikë)

Në vija të përgjithshme mund të thuhet se gjykata civile e ka të mundur të shqyrtojë në një gjykim të vetëm mosmarrëveshje apo kërtime të ndryshme, në zbatim të neneve 55, 57, 159 e 160 të Kodit të Procedurës Civile me kusht që të jetë kompetente nga pikëpamja lëndore dhe funksionale për shqyrtimin e tyre. Po ashtu, siç u theksua më lart, kur në objektin e gjykimit janë disa kërtime si të natyrës civile dhe administrative, kërtime të cilat janë paraqitur përpara datës 04.11.2013, ato mund të vazhdojnë të gjykohen nga gjykata ku ato janë paraqitur (gjykata civile), siç është theksuar edhe në vendimin unifikues nr. 3, datë 28.4.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Edhe gjykatat administrative në zbatim të neneve 23 e 24 të ligjit nr. 49/2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" (i ndryshuar) e ka të mundur të shqyrtojë bashkërisht disa kërtime ose disa padi, me kusht që të ketë kompetencën lëndore e funksionale për gjykimin e tyre.

Referuar kazusit konkret, në zbatim të vendimit unifikues nr. 3, datë 28.4.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë si kërkitet civile ashtu edhe ato administrative referuar kërkitet për anulimin e kontratës së privatizimit si kontratë administrative, do të vijojnë të gjykohen nga gjykatat civile.

4. Vlerësoni me hollësi lidhjen e objekteve mes tyre dhe mundësinë e shqyrtimit në një gjykim të vetëm dhe analizoni pyetjen: "A kemi para një bashkimi të thjeshtë apo një bashkimi të ndërruar?" (10 pikë)

EDUKIM PER DREJTESI

Referuar kazusit të paraqitur për zgjidhje në të cilin parashtrohet se pala paditëse ka paraqitur një padi me tre kërtime, vihet re se të treja ato karakterizohen nga nevoja e palës paditëse për të mbrojtur pronësinë mbi token e përfutur padrejtësisht nga pala e paditur. Kërkimi për anulimin e vendimit nr. 1, datë: 18.1.1996 të K.K.Pronave Dibër është një kërkim civil bazuar në përfundimet njësose të vendimit unifikues nr. 4, datë: 10.12.2013 të KBGJL.

Kërkimi për anulimin e kontratës së shitjes nënshkruar midis AKP-së dega Dibër dhe të paditurit I.L. më datë 31.8.2001, bazuar mbi faktet e kazusit duket si kërkim me natyrë administrative bazuar në analizën e bërë në dritën e vendimit njësose nr. 00-2023-3628 (302), datë: 22.09.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në të cilin është arsyetuar në lidhje me elementet ligjore që duhen mbajtur parasysh për identifikimin dhe dallimin e kontratave administrative nga ato civile, ku në këtë vendim njësose është parashtruar se:

- Së pari: Një kontratë do të konsiderohet administrative, kur krahas pranisë si palë të një organi publik (kriteri organik) verifikohet domosdoshmërisht edhe krijimi, ndryshimi apo shuarja e një marrëdhënie juridike konkrete, për shkak të zbatimit të normave të së drejtës publike (kriteri material), në funksion të një shërbimi publik dhe të realizimit të një interesi publik, të cilit i shërben. Për rrjedhojë, është edhe natyra juridike (shkaku ligjor i mosmarrëveshjes në gjykim), që do të përcaktojë gjykatën kompetente.
- Së dyti: Elementë kryesorë përcaktues për identifikimin e një kontrate administrative janë: shërbimi në interesin publik, që përbën shkakun e kontratës; kufizimi i lirisë kontraktore; epërsia e organit publik, në kuptim të kufizimit të vullnetit kontraktor të palës tjetër për kushte të caktuara të panegociueshme të kontratës, të rregulluara nga e drejta publike; karakteri specifik i kontratës, lidhur me të drejtën e organit publik për tërheqje të njëanshme nga kontrata, kur nuk arrihet marrëveshja për ndryshim ose prishje të saj, kundrejt detyrimit për t'i paguar palës private dëmin e shkaktuar.
- Së treti: Në një kontratë administrative palët qëndrojnë në raport me njëra-tjetrën në një marrëdhënie që imponohet nga parimi i ushtrimit të fuqisë/pushtetit sovran, ku mbajtësi i këtij sovraniteti bazohet te kuadri normativ i së drejtës publike. Kontrata është administrative, kur pavarësisht pjesëve të saj që normohen nga e drejta private, evidentohet qartë se rregullimi në tërësi i saj nga normat e së drejtës publike peshon më shumë.
- Së katërti: Dallimi mes kontratës publike dhe private, në funksion të përcaktimit të kompetencës lëndore, bëhet jo nëpërmjet leximit literalisht të kontratës, por nëpërmjet analizës në thelb të përmbajtjes së saj dhe natyrës së mosmarrëveshjes. Objekti, qëllimi dhe normat, që

rregullojnë marrëdhënien juridike, duhet të evidentohen qartë si nga palët në proces, ashtu edhe në analizën dhe konkluzionin, që nxjerr gjykata lidhur me këtë çështje.

Kërkimi për detyrimin e palës së paditur të njohë pronar paditësit ka karakteristikat e një kërkimi tipik të padisë së kërimit të sendit sipas nenit 296 të Kodit Civil, ndaj klasifikohet si kërkim civil.

Të tre kërkimet e objektit të padisë kanë lidhje me njëri-tjetrin pasi nga njëra anë synojnë të zhbëjnë aktet me të cilat i ka kaluar pronësia të paditurit e nga ana tjetër synojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes së pronësisë midis palëve, duke u njohur pala paditëse si pronare e sendit objekt gjykimi dhe duke u detyruar i padituri ti njohë ata pronar.

Sa i përket pyetjes a jemi para një bashkimi të thjeshtë apo një bashkimi të ndërvarur, i referohemi trajtesës teorike të këtyre koncepteve të bërë në vendimin unifikues nr. 4, datë: 10.12.2013 të KBGJL, duke theksuar se qëndrimi njësues, por jo analiza e kuptimit të bashkimit të thjeshtë dhe atij të ndërvarur, ka ndryshuar më pas me vendimit unifikues nr. 3, datë: 28.4.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Konkretisht sipas arsyetimit të KBGJL kemi një bashkim të thjeshtë të disa kërtimeve (objekteve) në një padi kur ato kanë të përbashkët shkakun e padisë, por zgjidhja e njërit kërkim nuk kushtëzon zgjidhjen e kërtimeve të tjera. Me konkretisht paditësinë për një padi të ngritur në disponibilitetin e tij ka paraqitur disa kërtime, zgjidhja e të cilëve nuk kushtëzon zgjidhjen e kërtimeve të tjera. Pra gjykata mund të vendosë për disa kërtime pranimin dhe disa të tjerë rrëzimin e tyre pa u kushtëzuar zgjidhja e njërit kërkim nga zgjidhja e tjetrit. Këto kërtime mund të ngrihen dhe veçmas në një padi tjetër. Në lidhje me këtë, në rast se kërkimet në të njëjtën padi janë të natyrave të ndryshme, pra civile dhe administrative, gjykata konkrete në rastin kur kemi bashkim të thjeshtë të objekteve të padisë detyrimisht duhet të veçojë objektet që nuk janë në kompetencën e saj lëndore, duke ja kaluar ato gjykatës kompetente (neni 61 i K.Pr.Civile apo neni 18 i Ligjit 49/2012).

Në vijim KBGJL kanë përcaktuar se kemi një bashkim të ndërvarur kur zgjidhja e njërit nga kërkimet në të njëjtën padi, kushtëzon dhe zgjidhjen e njërit apo disa kërtimeve të tjera.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vlerësuar se është detyrë e gjykatës të identifikojë natyrën e mosmarrëveshjes objekt gjykimi si e natyrës civile apo asaj administrative duke iu referuar për këtë qëllim kërtimeve dhe shkakut që rezultojnë nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar.

Referuar kërtimeve të bashkuara në objektin e padisë së parashtruar në kazus mund të thuhet se kërkimi kryesor është mbrojtja e pronësisë së paditësit kundrejt të paditurve dhe kërkimet e tjera janë kërtime të ndërvarura nga ky kërkim, d.m.th që kushtëzohen nga zgjidhja e tij prej gjykatës civile. Këtu duhet theksuar se ky përfundim përforcohet referuar përfundimit njësues të vendimit nr. 4, datë: 10.12.2013 sipas të cilit gjykimet me objekt kundërshtimin e vendimeve të ish Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkive janë me natyrë civile.

5. Cili është fati i gjykimit, nëse ju jeni gjyqtari që do të rishqyrtoni çështjen? (10 pikë)

Së pari duhet theksuar se vendimi objekt kundërshtimi është ai i Gjykatës së Apelit nr.1823, datë: 13.11.2008 për të cilin kompetenca lëndore e rishikimit i përket Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, bazuar në natyrën civile të mosmarrëveshjes dhe rregullit njësues të vendosur në vendimin unifikues nr. 3, datë 28.4.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Së dyti, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë do të duhet të konstatojë cenim të të drejtës së qasjes në gjykatë për palën paditëse për shkak të vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit për prishjen e vendimit nr. 258, datë: 10.5.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Kjo për shkak se jo vetëm Gjykata e Apelit ka zbatuar gabim nenet 59 e 468 të Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me pasjen e juridiksionit gjyqësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, por nuk ka zbatuar as vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 4, datë 24.3.2005 sipas të cilit: "Pavarësisht nga momenti i regjistrimit të çështjes për gjykim (para apo pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri), në të gjithë rastet kur padia për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave është ngritur nga

persona të tjerë që kanë fituar të drejta pronësie mbi pronat e trajtuara nga ky vendim, është gjykata ajo që ka juridiksionin për shqyrtimin e këtyre çështjeve.” dhe as vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 24.3.2005, në të cilin është vendosur se: “[...] të gjitha çështjet, të cilat kanë të bëjnë me kundërshtimin e vendimeve të Komisioneve të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish Pronarëve, që janë marrë në zbatim të Ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 dhe që janë kundërshtuar në gjykatë përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", janë në juridiksionin gjyqësor dhe jo në atë administrative.”

Së treti, neni 59 i Kodit të Procedurës Civile trajton rastin e konstatimit nga gjykata të mungesës së juridiksionit për shqyrtimin e çështjes, ndër të tjera, kur ky i përket një organi administrativ, për shkak se ligji parashikon shprehimisht detyrimin e shterimit të rrugës administrative të ankimit për të pasur më pas qasje në gjykatë. Në rastin e kazusit të shtruar për analizë, paditësit jo vetëm janë persona të tretë në lidhje me vendimmarrjen e ish K.K.K Pronave Dibër për të paditurin I.L, ndaj për ta ligji i kohës kur kanë paraqitur padinë (vendimi i Gjykatës Mat është i datës 10.5.2004, ndaj padia është paraqitur para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9235, datë: 29.07.2004) nuk ka vendosur asnjë kufizim për të ndjekur ndonjë rrugë administrative para paraqitjes së padisë në gjykatë, duke mos pasur kështu mundësi argumentimi të mospasjes së juridiksionit nga gjykatat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së pronësisë midis palëve.

Së katërti, në kushtet kur Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar çështjen në themel, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet të vendosë prishjen e vendimit nr. 1823, datë: 11.3.2008 të Gjykatës së Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë.



Kazusi Penal Nr. 7

1. Vepra penale e kryer nga të gjykuarit është ajo e rrëmbimit ose e mbajtjes peng të personit parashikuar në nenin 109 të Kodit Penal apo ajo e heqjes së paligjshme të lirisë dhe vetëgjyqësia parashikuar nga neni 110 dhe 277 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal (10 pikë)

Nga analiza, interpretimi i dispozitave të Kodit Penal, bazuar në jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (vendimin unifikues nr. 1/2005) rezulton se vepra penale e kryer nga të gjykuarit nuk është ajo e rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit, parashikuar në nenin 109 të Kodit Penal, por heqja e paligjshme të lirisë dhe vetëgjyqësia, parashikuar nga nenet 110 dhe 277 në lidhje me nenin 25 të K.P. Për të arritur në këtë përfundim është e domosdoshme analiza dhe interpretimi i elementeve të figurës së të tre veprave penale, atë të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit (neni 109), heqjen e paligjshme të lirisë (neni 110) dhe vetëgjyqësinë (neni 277).

Heqja e paligjshme e lirisë, neni 110 i Kodit Penal, parashikon mbrojtjen e përgjithshme të lirisë së personit kundrejt çdo lloj privimi të saj, dhunimit dhe nënshtrimit të detyrueshëm fizik nga cilido, veprime këto që nuk janë të autorizuar apo lejuara nga ligji. Motivi, veprimet a mosveprimet e autorit të kësaj vepre penale nuk janë të një natyre të përcaktuar shprehimisht prej saj. Heqja e paligjshme e lirisë mund të realizohet nëpërmjet veprimeve (aktive) duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në to: ushtrimi i dhunës mbi personin duke e rrëmbyer, mbajtur peng, e shoqëruar me bllokimin, prangosjen, etj., ose në forma të tilla si injektimi i substancave narkotike që pamundësojnë reagimin dhe sjelljen normale të viktimës, dhunës psikike dhe kanosjeve nëpërmjet përdorimit dhe drejtimit të armëve ndaj viktimës. Nuk përjashtohen në heqjen e paligjshme të lirisë edhe përdorimi i formave të mashtrimit dhe gënjeshtërisë me synim dhunimin e lirisë apo vetëprivimin e viktimës nga liria personale për gjëndjen e tij në situata të një sëmundje të pashërueshme, të rëndë, ngjitëse, etj., në situata të një rreziku (që në fakt nuk ekziston), vendosjen në gjendje sugestionimi a supersticioziteti, etj.

Heqja e paligjshme e lirisë (neni 110 i K.P.), nga pikëpamja e anës subjektive realizohet për qëllime dhe motive që nuk janë nga ato të përfshira në nenin 109 të K.P., pavarësisht nëse janë a pretendohen të jenë të drejta a të ligjshme dhe pavarësisht nëse ato janë me natyrë pasurore, materiale ose të një natyre a marrëdhënie tjetër që nuk kualifikohen si të tilla. Përsa i përket përcaktimit të heqjes së paligjshme të lirisë, ardhjes së pasojës dhe shkallës së tyre, është e rëndësishme të vërtetohet një kohëzgjatje e matshme dhe e mjaftueshme e privimit të lirisë, e cila jo domosdoshmerisht duhet të jetë e gjatë. Nuk përbën heqje të paligjshme të lirisë vërtetimi i kësaj gjendje objektive në një çast të caktuar ose kalimtar, me motivim dhe në kryerje e sipër të një veprimi të caktuar.

Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit, neni 109 i Kodit Penal synon të mbrojë në radhë të parë lirinë e personit. Interpretimi dhe zbatimi korrekt i kësaj dispozite kërkon të mbahen parasysh ndërmjet të tjerave, dy elemente thelbësore: a) përfitimi i padrejtë e realizimi i interesave të tjera të paligjshme në kuptim të rasteve të parashikuara nga dispozita dhe b) lirimi i viktimës përkundrejt marrjes së këtij përfitimi.

Edhe pse është e vendosur në seksionin VII "veprat penale kundër lirisë së personit", neni 109 ka për objekt jo thjeshtë mbrojtjen e lirisë personale por edhe paprekshmërinë dhe mbrojtjen e pasurisë. Veprimet dhe motivet e autorëve të veprës penale e kthejnë viktimën në një instrument, "send" të cenuar si qenie njerëzore dhe në interesat e tij pasuror e jopasuror. Ekziston një lidhje e ngushtë midis qëllimit të veprës, përfitimit dhe lirimit të personit për këtë shkak. Ai shkëmbehet, pra lihet i lirë, vetëm përkundrejt realizimit të përfitimit të pasurisë, përfitimeve dhe qëllimeve të tjera të parashikuara në dispozitë.

Në aspektin subjektiv, ekzistenca ose jo e një marrëveshje apo marrëdhënie të mëparshme mes viktimës dhe autorit të veprës penale mund të përbëjnë edhe shkakun për kryerjen e veprës penale të rrembimit a mbajtjes peng të personit, por ky aspekt duhet të konsiderohet i përfshirë në qëllimin final të realizimit të një përfitimi të padrejtë e të paligjshëm, si një cmim, kompensim për lirimin e viktimës, apo edhe për të lehtësuar gjendjen e të dëmtuarit që i është hequr liria në mënyrë të paligjshme.

Neni 109 është i qartë në këtë drejtim, sepse ligjvënësi ka përcaktuar vendimtar në kuptim të anës subjektive realizimin e qëllimit "... për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër" dhe jo shkakun e saj. Pra, qëllimi i përfitimit dhe lirimi i viktimës përkundrejt realizimit të këtij qëllimi, përbëjnë në mënyrë të njëkoheshme elementë thelbësorë të kësaj vepre penale.

Neni 109 i Kodit Penal (ashtu sikurse edhe neni 110 i tij), duhet të konsiderohet i kryer me heqjen e paligjshme të lirisë, rrembimin a mbajtjen peng të viktimës, pavarësisht nëse autori ka arritur ose jo të realizojë përfitimet dhe qëllimet e parashikuara në vepër dhe përkundrejt të cilave ai do të lirojë viktimën.

Nëse gjatë gjykimit vërtetohet natyra e padrejtë e përfitimit si motiv për rrembimin a mbajtjen peng, jemi perpara rastit kur një person privohet nga liria, pra, rrëmbehet a mbahet peng dhe i kërkohet një përfitim i padrejtë përkundrejt lirimit të tij. Në këtë rast është evidente lidhja e ngushtë ndërmjet veprimeve të kryera, qëllimit të përfitimit të padrejtë dhe kërkesës për të dhënë përfitimin përkundrejt lirimit të viktimës. Prandaj në këto raste, Kolegjet çmojnë se figura e veprës penale që duhet të gjejë zbatim është ajo e rrembimit ose marrjes peng të personit, neni 109 i K.P. Po ashtu, fakti që ka ekzistuar një kërkim a marrëdhënie e mëparshme qoftë edhe e paligjshme ndërmjet të autorit të veprës dhe viktimës, shërben vetëm për të individualizuar llojin dhe masën e dënimit, por jo aspektet e tjera të anës subjektive që kërkon neni 109 i Kodit Penal, realizimi i një përfitimi të padrejtë përkundrejt lirimit të viktimës.

Një nga elementet specifike që është dallues dhe përcaktues në kualifikimin e veprës sipas nenit 109, apo nenit 110 të Kodit Penal lidhet me anën subjektive të tyre, pikërisht me qëllimin, motivin e autorit të veprës penale dhe që ka të bëjë me realizimin e një përfitimi pasuror, përfitimeve a qëllimeve të tjera (të ngjashme). Kjo situatë del nga vetë kuptimi në tërësi i nenit 109 të Kodit Penal ku përfitimet dhe qëllimet duhet të jenë të padrejta, të përbëjnë një interes të paligjshëm, për vete ose për të tjerët, përkundrejt lirimit të viktimës. Motivi dhe qëllimi i veprës sipas nenit 109 të K.P. lidhet me realizimin në mënyrë të padrejtë të një përfitimi pasuror, të një qëllimi tjetër të paligjshëm a në rrugë të paligjshme, përfshire edhe qëllime të tjera të ngjashme me ato të përmendura shprehimisht në këtë dispozitë.

Ndërkohë, heqja e paligjshme e lirisë nuk i ka të përcaktuara motivet në kuptim të anës subjektive, gjë që do të thote se ato janë të tilla që nuk përfshihen në nenin 109 të K.P. ose në vepra të tjera penale.

Duke analizuar përmbajtjen e nenit 109 të Kodit Penal rezultojnë dy çështje thelbësore për anën objektive të kësaj vepre. Kështu, sjellja dhe veprimet e autorit, sipas nenit 109 të Kodit Penal janë: "rrembimi ose mbajtja peng e personit", që në vetvete nuk janë gjë tjetër veç se veprime që kanë kuptim të njejtë ose sjellin si pasojë heqjen e paligjshme të lirisë së viktimës.

Vetegjyqesia, neni 277 i Kodit Penal parashikon ushtrimin e një të drejte nga personi që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri, pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror. Kjo dispozitë synon jo vetëm të mbrojë ushtrimin e autoritetit shtetëror, por edhe që të parandalojë e ndëshkojë sjelljet dhe veprimet shoqërisht të rrezikshme me të cilat autori i atribuon vetes të drejtën për të realizuar një të drejte a zgjidhur një mosmarrëveshje që ka me të dëmtuarin, duke shmangur rrugën e parashikuar nga ligji për t'i u drejtuar organit kompetent shtetëror. Në këtë kuptim, autori i veprës vepron duke shkelur dhe "zëvendësuar"

veprimin e organit kompetent, i cili nga ana e tij, ka juridiksionin, kompetencen dhe detyrën që të zgjidhë konfliktin mes palëve sipas ligjit, me objektivitet dhe paanshmëri. Ky veprim i autorit, në vetvete është i paligjshëm dhe arbitrar.

Nuk do të jemi përpara rastit të vetëgjyqësisë, ushtrimit arbitrar, të paligjshëm të së drejtës, nëse autori vepron mbi sendin me synimin për të mbrojtur posedimin e ligjshëm dhe aktual të tij të cenuar apo shqetësuar nga veprimi i paligjshëm i një personi të tretë, përderisa nuk jemi përpara detyrimit ligjor ose mundësisë për t'ju drejtuar organit kompetent shtetëror, a gjykatës.

Pavarësisht se nuk përmendet shprehimisht në dispozitë, nga pikëpamja e anës objektive, vetëgjyqësia kryhet nga autori nëpërmjet ushtrimit arbitrar të së drejtës, me forma të ndryshme të dhunes fizike a psikike (kanosjes, etj.), drejtpërdrejt mbi personin ose indirekt, duke vepruar mbi sendin a interesin mbi të cilin ekziston apo pretendohet se ekziston e drejta (e ligjshme) e autorit të veprës. Objekti mbi të cilin vepron autori jo domosdoshmërisht është ai për të cilin ushtron vetëgjyqësinë, mbi të cilin ai ka të drejtën a interesin e ligjshëm ose të pretenduar se i përket autorit. Gjithashtu është e rëndësishme që të ekzistojë mjeti, rruga ligjore dhe mundësia për autorin që të realizojë të drejtën e tij duke iu drejtuar organit kompetent shtetëror, e në veçanti, gjykatës.

2. Cfarë vepra të tjera ka konsumuar i gjykuari T? (10 pikë)

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, plotësisht, duhet të analizohet aplikimi i përgjegjesisë penale për të gjykuarin T, për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë i Kodit Penal në bashkëpunim me të gjykuarin P dhe E, si dhe aplikimi i përgjegjesisë penale për veprën penale të vjedhjes e parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, lidhur me: "...në vijim të veprimeve të tyre kanë hipur në dy makina, njëra nga të cilat i përkiste vetë viktimës dhe janë nisur në drejtim të fshatit ...".

Lidhur me çështjen e parë, duke marrë në konsideratë vendimarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe të Gjykatës së Apelit, lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë (vendimi njësuës), për të gjykuarin T lidhur me veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë i Kodit Penal në bashkëpunim, duhet të analizohet nëse në rastin e heqjes së paligjshme të lirisë së personit shoqëruar me kërcënim për përdorimin e armës, të gjithë pjesëmarrësit (bashkëpunëtorët), si autorët materialë dhe ata që kanë dhënë ndihmën e nevojshme (të ashtuquajturit "basisti"), janë, gjithashtu, përgjegjës për krimin e posedimit të paligjshëm të armëve, duke pasur parasysh se planifikimi i ndërmarrjes kriminale përfshin edhe momentin që përfaqëson përdorimin e armëve dhe, për rrjedhojë, posedimin e paligjshëm të tyre për të kryer kërcënimin, ose dhunën e nevojshme, thelbësore për këtë lloj krimi.

Pra edhe pse armën e posedon vetëm i gjykuari P, i gjykuari T është autor material i krimit të kryer. Të gjithë të pandehurit kishin marrë pjesë në planifikimin e krimit, secili mori përsipër rolin e tij dhe të gjithë ishin në dijeni të përdorimit të planifikuar të armës nga autori tjetër material i krimit.

Konceptimi i sipërmarrjes kriminale përfshin edhe momentin përfaqësues të përdorimit të armëve (pra dhe të mbajtjes pa leje) për të kryer kërcënimin ose dhunën e nevojshme, thelbësore për këtë lloj krimi. Pjesëmarrja e personave në mbajtjen, ose përdorimin e një arme nuk mund të përjashtohet nga fakti se arma i përket vetëm njërit prej pjesëmarrësve. nëse me këtë person të tjerët kanë planifikuar krime që parashikojnë nevojën e përdorimit të armës dhe më pas i kanë kryer këto krime duke shoqëruar njëri-tjetrin në vendin ku do të kryheshin. Përdorimi i armës, do të ishte një ngjarje tashmë e planifikuar dhe e pranuar nga të gjithë, dhe jo një zhvillim logjikisht i parashikueshëm.

Ndërsa lidhur me aplikimin e përgjegjesisë penale për veprimet "...në vijim të veprimeve të tyre kanë hipur në dy makina, njëra nga të cilat i përkiste vetë viktimës dhe janë nisur në drejtim

Ylli Gjeto...

[Signature]

të fshatit... ", duhet marrë në konsideratë nëse i gjykuari T ka vepruar me qëllimin e vetëm për shfrytëzimin e përkohshëm të sendit të vjedhur (automjetit të viktimës) dhe pas përdorimit të përkohshëm, sendi është kthyer menjëherë.

E ashtuquajtura vjedhje e përdorimit përfaqëson dy elemente të veçanta përbërëse, të identifikuar përkatësisht në qëllimin për të përdorur përkohësisht sendin e vjedhur dhe në përdorimin e përkohshëm të shoqëruar me kthimin e menjëhershëm të mëpasshëm të sendit ose të tantundem eusdem generis nëse bëhet fjalë për sende të këmbyeshme.

Për efekt të aplikimit të përgjegjësisë penale vjedhja e përdorimit kërkon dy elementë thelbësorë, qëllimi ekskluziv i përdorimit të përkohshëm të sendit të vjedhur dhe kthimi i menjëhershëm (pas përdorimit). Një kthim i tillë, edhe nëse jo domosdoshmërisht spontan, duhet të jetë të paktën vullnetar, domethënë duhet të paraqitet si një zbatim i lirë i qëllimit fillestar për kthim. Prandaj, të gjitha shkaqet, të cilat përcaktojnë një detyrim për kthim, e bëjnë të konsumueshme veprën penale, këtu përfshihen të gjitha shkaqet, madje edhe ato të pavarura nga vullneti i të pandehurit, që pengojnë kthimin. Gjithashtu duhet të analizohet nëse vjedhja e përdorimit konkuron me veprën penale të heqja e paligjshme e lirisë sipas konkurimit fiktiv të përhithjes.

3. Për të bërë dallimin ndërmjet veprave të lartpërmendura si dhe për të konstatuar faktin e konkurimit ose jo ndërmjet tyre a është e mjaftueshme vetëm analiza e anës subjektive për të bërë kualifikimin e saktë të veprës penale të kryer nga të gjykuarit, apo elementet dhe rrethanat e anës subjektive duhen shqyrtuar dhe analizuar së bashku me elemente e rrethana të tjera të anës objektive? (10 pikë)

Bazuar në jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (vendimin unifikues) për të bërë dallimin ndërmjet veprave penale analiza e anës subjektive të veprave penale është vendimtare për të bërë kualifikimin e saktë të veprës penale të kryer nga të gjykuarit. Nga rrethanat e faktit rezulton se qëllimi i veprimeve kriminale të kryera nga të gjykuarit ishte ushtrimi i një të drejte, pa ju drejtuar organeve kompetente apo gjykatës, për të marrë një shumë të holla që ndonëse njihej si detyrim kundrejt tyre, i dëmtuari nuk ua kishte dhënë dhe e mbante padrejtësisht. Këto elemente dhe rrethana të anës subjektive, duke u shqyrtuar dhe analizuar së bashku me elemente e rrethana të tjera të anës objektive, gjithashtu bëjnë të mundur dallimin ndërmjet veprave penale të lartpërmendura, si dhe konkurimin ose jo ndërmjet tyre.

Duke analizuar sa më sipër rrethanat e faktit dhe elementët e figurës së veprave penale të vëna në shqyrtim, bazuar në jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë mund të konkludohet se nëse mungon përfitimi i padrejtë, pra synohet a pretendohet të realizohet një interes i ligjshëm, përkundrejt ndërprerjes dhe dhunimit të lirisë (rëmbimit a marrjes peng të viktimes), atëherë jemi përpara veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë. neni 110 K.P. e cila konkuron me veprën penale të vetëgjyqësisë, neni 277 i K.P. Natyra e drejtë apo e padrejtë e përfitimit a interesit duhet të çmohet jo mbi bazën e vlerësimit personal të autorit të veprës, por nisur nga vlerësimi objektiv i tërësisë së rrethanave që rezultojnë në gjykimin e çështjes.

Dispozitat e neneve 109, 110 dhe 277 të Kodit Penal parashikojnë mbrojtjen e marrëdhënieve shoqërore që cenojnë personin dhe pasurine. Ndërkohë, në rastin e vetëgjyqësisë, mbrohen marrëdhëniet që lidhen me rendin dhe sigurinë publike. është e kuptueshme se ligjvënisi bën një rregullim specifik por edhe të ndërsjelltë të marrëdhënieve të mbrojtura nëpërmjet këtyre dispozitave penale.

Në rastet e neneve 109 dhe 110, personi është cenuar në të drejtën e tij për të gëzuar lirinë personale. Rëmbimi ose mbajtja peng janë forma të ushtrimit të dhunës fizike të shoqëruara

ose jo me elemente të tjerë të natyrës së dhunës psikike dhe që synojnë e sjellin si pasojë një rezultat të vetëm: heqjen e paligjshme të lirisë personale. Për këto arsye, pavarësisht nga dallimi për sa i përket anës subjektive, këto dy vepra penale nuk konkurojnë me njëra-tjetrën.

Ndryshe nga neni 109 të Kodit Penal, në kuptim të anës subjektive, në nenin 277 të këtij Kodi, motivi dhe qëllimi lidhen me pretendimin për të mbrojtur një qëllim të drejte a interes të ligjshëm. Në këtë rast, veprimet të njëjta a të ngjashme në kuptim të anës objektive nuk ndikojnë në përfundimin që neni 109 nuk konkuron me nenin 277 të Kodit Penal.

Ndërkohe që konkurojnë me njëri-tjetrin neni 110 me nenin 277, për arsyen thelbësore që vetëgjyqësia, neni 277, konsumohet për motive të mbrojtjes së një të drejte a interesi të ligjshëm, pa ju drejtuar organit kompetent. Pavarësisht nga e drejta dhe interesi i ligjshëm që mbrohet, veprimet e autorit, të çdo forme qofshin, drejtohen ndaj personit ose sendeve, në mënyrë arbitrare. Nëse këto veprime bëhen duke u shoqëruar me format e privimit të lirisë së personit atëherë autori ka konsumuar edhe një vepër tjetër penale, atë të heqjes së paligjshme të lirisë, neni 110 i K.P.

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, rezulton se të gjykuarit kanë konsumuar veprat penale të heqjes së paligjshme të lirisë dhe vetëgjyqësisë, në bashkëpunim me njëri tjetrin, parashikuar nga nenet 110/2 dhe 277 e 25 të K.P. Në këtë përfundim arrihet edhe duke marrë në konsideratë elementet e konkurimit fiktiv të specialitetit, përthithjes dhe subsidiaritetit. Gjithashtu duhet të analizohet rrethana cilësuese e parashikuar në paragrafin 2 të nenit 110 të Kodit Penal, në të cilin parashikohet se: “..... *shoqërohet me vuajtje të rënda fizike, kryhet në bashkëpunim,...*”. Nëse rrethanat faktike “*të pandehurit me forcë dhe nën kërcenimin e armës e kanë marrë me vete viktimës...*” përfshihen në konceptin “shoqërohet me vuajtje të rënda fizike”.

4. Cili është mendimi juaj mbi pretendimin e mbrojtjes lidhur me përdorshmërinë e provës së përgjimit? (10 pikë)

Në këtë rast kemi të bëjmë me një përgjim ambiental, të kryer në mjediset e shoqërimit të personave të dyshuar në Komisariatin e Policisë. Ligji dallon përgjimin në vende publike dhe në vende private. Në rastin e parë, për përdorshmërinë e rezultatit, vlen autorizimi i prokurorit (neni 221.2, në lidhje me nenin 222.8 të KPP), kurse në rastin e dytë, kusht për përdorshmërinë e rezultatit është që veprimi të lejohet nga një vendim i gjykatës (neni 222.2 dhe 222.4 të KPP).

Çështja që shtrohet ka të bëjë me faktin nëse përgjimi ambiental i zhvilluar në ambientet e Komisariatit të Policisë do të konsiderohet si “përgjim në vend publik” apo si “përgjim në vend privat”?

Ligji nuk jep një përkufizim të koncepteve “vend publik” dhe “vend privat”. Praktika e Gjykatës së Lartë orienton që për të gjykuar lidhur me natyrën e vendit, duhet që vlerësimi të kryhet rast pas rasti, duke mbajtur parasysh disa kritere, sikundër janë:

- i) nëse vendi përdoret për qëllime private të personit;
- ii) nëse personi nën përgjim (apo personi me të cilin personi nën hetim është duke komunikuar) ka mundësi të përjashtojë persona të tretë nga ambienti nën përgjim; si dhe
- iii) nëse ambienti nën përgjim është në pronësi publike apo private.

Për sa i përket natyrës publike apo private të vendit, praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë ka orientuar se mjediset e Komisariateve të Policisë (dhe veçanërisht dhomat ku mbahen personat në gjendjen e kufizimit të lirisë) janë mjedise publike, në të cilat përgjimi lejohet vetëm me autorizimin e prokurorit, pa qenë i nevojshëm që ky autorizim të vlerësohet si i

ligjshëm dhe kohëzgjatja të disponohet me vendim të gjykatës¹. Kriteri vlerësues, sipas KPGJL nuk duhet lidhur detyrimisht me lirinë e aksesit në këto mjedise, sepse kufizimi i hyrjes së publikut lidhet me arsye sigurie.

Megjithatë, ka edhe argumente se “vende publike” duhet të konsiderohen mjediset ku publiku ka akses të lirë, sikundër mund të jenë parqet publike, rrugët për këmbësorë në qendrat e qyteteve, zonat e parkimit publik, rrugët e lagjeve të banimit, zona të tilla si qendrat sportive, stacionet e transportit publik, teatrot, kinematë, etj. Në këtë këndvështrim, Komisaritetet ku të dyshuarit shoqërohen me detyrim nuk mund të konsiderohen vende publike dhe në dhomat e shoqërimit personave të dyshuar nuk mund t’u mohohet e drejta privatësisë. Një pjesë e praktikës gjyqësore, ndër vite, përgjimet ambientale të kryera në mjediset e brendshme të Komisariateve të Policisë, i ka konsideruar të ligjshme atëhere kur vendimi i prokurorit për përgjimin ambiental paraqitej në gjykatë me një kërkesë për vlefësimin e tij.

Në kushtet e praktikave të ndryshme dhe në mungesë të një vendimi njësesues të KBGJL, zgjidhja e këtij rasti do të vlerësohet në raport me nivelin e analizës dhe argumenteve të dhëna nga kandidati. Nëse mjedisi do të konsiderohet publik, atëhere pretendimi i mbrojtjes do të duhet të rrëzohet; nëse argumenti do të jetë në favor të një mjedisi privat, natyrisht, në mungesë të një vendimi gjyqësor, përgjimi do të konsiderohet i paligjshëm dhe prova që buron prej tij – e papërdorshme.

5. A duhet të marrë ndonjë vendim gjykata e themelit lidhur me faktin e mosnjohimit të viktimës për t’u paraqitur në seancë paraprake? Nëse po, duhet ta bëjë kryesisht, apo mbi kërkesën e palëve? (10 pikë)

Thirrja e viktimës në seancë paraprake, kur identiteti dhe vendbanimi i saj janë të njohura, është një akt i detyrueshëm nga ligji, moskryerja e të cilit sanksionohet me pavlefshmëri absolute (neni 128/a, par. 1, shkronja c) i KPP). Nisur nga rregulli i normuar në nenin 131 të KPP (pavlefshmëria e prejardhur), kjo pavlefshmëri i transmetohet edhe vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq.

Duke qenë se pavlefshmëritë e natyrës absolute janë të pakorrigjueshme (neni 128/a, par. 2 i KPP), si rregull, gjykata e themelit duhet që ta prishë vendimin për dërgimin e çështjes në gjyq dhe të rikthejë çështjen për rigjykim në seancë paraprake, duke lënë detyrë që të thirret viktimja dhe të dëgjohen pretendimet e saj.

Kjo zgjidhje parimore është vënë në dyshim nga KPGJL në disa vendime të tij², me argumentin se gjyqtari i themelit nuk ka të drejtë të shpallë të pavlefshëm vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake, por ka të drejtën dhe detyrimin të korrigjojë shkeljet procedurale që konstaton se janë kryer në seancë paraprake. Në zbatim të këtij vendimi të KPGJL, korrigjimi i aktit të pavlefshëm, mund të kryhet duke e thirrur viktimën në gjykimin e themelit dhe duke e njohur me të drejtat e saj. Pas kësaj, viktimja ftohet që të paraqesë pretendimet e saj para gjykatës së themelit. Kjo do të ishte, gjithashtu, një zgjidhje e pranueshme e këtij kazusi.

Përsa i përket pyetjes nëse gjykata ndërhyt kryesisht apo me kërkesë të palëve, vlen kjo përgjigje: gjykata në këtë rast vepron kryesisht, pavarësisht nga fakti nëse këtë pretendim e ka ngritur ose jo ndonjëra nga palët e interesuara, sepse vlen rregulli që pavlefshmëritë e


¹ Vendim Nr. 616 datë 14.06.2022 i KPGJL. Për raste të ngjashme, shih edhe vendimin nr.199 datë 29.10.2014, nr.159 (00-2011-1132), datë 23.11.2011.

² Shih vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.00-2020-485, datë 24.12.2020; nr.262-2019 akti, datë 15.05.2020 dhe nr. 23, datë 30.01.2024.

naturës absolute ngrihen edhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit (neni 129.1 i KPP).

Jlli Jitovzishaj

Henrik Riponj



KAZUS ADMINISTRATIV 4

Përgjigjet e çështjeve të shtruar për analizë dhe zgjidhje

Cështja nr. 1

A ka qenë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë kompetente nga pikëpamja lëndore, funksionale dhe tokësore për shqyrtimin e mosmarrëveshjes juridike në gjykim? (7 pikë)

Përgjigje:

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë ka qenë gjykata kompetente nga pikëpamja lëndore.

1.1 Mosmarrëveshja në gjykim ka për objekt detyrimin e palës së paditur t'i njohë paditësit gradën "Kryekomisar", pra detyrimin e organit administrativ ti njohë këtë gradë dhe paditësi ta fitojë atë gjyqësisht, në kuadër të një mosmarrëveshjeje administrative në lidhje me të drejtat që si funksionar publik pretendon se i takojnë sipas Ligjit të posaçëm nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit".

1.2 Kompetenca lëndore e gjykatës administrative për mosmarrëveshje të kësaj natyre, parashikohet nga shkronja "ç", e nenit 7, të Ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë ka qenë gjykata kompetente nga pikëpamja funksionale.

2.1 Të gjitha mosmarrëveshjet administrative që Kushtetuta dhe ligji nuk ia ka caktuar në kompetencë Gjykatës Kushtetuese apo ndonjë gjykatë tjetër, janë në kompetencë lëndore të gjykatave administrative.

2.2 Nga ana tjetër, me përjashtim të rasteve kur ligji ka parashikuar shprehimisht që mosmarrëveshje të caktuara administrative gjykohen në shkallë të parë nga Gjykata Administrative e Apelit, mosmarrëveshjet e tjera administrative të çdo lloji shqyrtohen në shkallë të parë dhe janë në kompetencën funksionale të gjykatave administrative të shkallës së parë.

2.3 Juridiksioni dhe kompetenca funksionale e gjykatave administrative parashikohen nga nenet 8 dhe 10, në lidhje me nenin 7, të Ligjit nr.49/2012, i ndryshuar.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë nuk ka qenë gjykata kompetente nga pikëpamja tokësore.

3.1 Në çështjen konkrete, me anë të padisë kërkohet detyrimi i palës së paditur ti njohë paditësit gradën "Kryekomisar" dhe gjykata të disponojë fitimin e kësaj grade nga paditësi. Vetë paditësi, sipas parimit të disponimit maksimal, ka përcaktuar si palë të paditur Drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe kërkon që detyrimet përkatëse ti ngarkohen nga gjykata kësaj pale.

3.2 Nga ana tjetër, Ligji i posaçëm nr.108/2014, ka përcaktuar Drejtorin e Policisë së Shtetit dhe komisionin e gradimit pranë kësaj Drejtorie si organe administrative që kryejnë veprimet administrative, ushtrojnë kompetencat dhe përmbushin detyrimet përkatëse që parashikon ligji lidhur me gradimin e punonjësve të Policisë së Shtetit. Selia e Drejtorisë së Policisë së Shtetit është në Tiranë.

3.3 Në çdo rast, edhe vetë paditësi nuk e ushtron detyrën pranë ndonjë organi publik, nuk ka banim a vendqëndrimi në njësi territoriale- administrative për të cilat Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër ka pasur kompetencën tokësore.

3.4 Në përfundim, veçanërisht bazuar në pikën 1, të nenit 11, të Ligjit nr.49/2012 i ndryshuar, në lidhje me shkronjën “b)” dhe “ç)”, të nenit 7 të këtij Ligji, gjykata administrative e shkallës së parë kompetente nga pikëpamja tokësore është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Cështja nr. 2

Cila është faza procedurale kur mund të ngrihej dhe pretendohet kompetenca tokësore dhe a mund të shqyrtohej ajo kryesisht nga gjykata në kuptim të neneve 11 dhe 13 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar ? (8 pikë)

Përgjigje:

1. Sipas pikës 1, të nenit 13 të Ligjit nr.49/2012, i ndryshuar, ngritja e pretendimit nga palët mbi kompetencën lëndore dhe funksionale parashtrohet në çdo gjendje, fazë e shkallë të gjykimin të çështjes. Madje, vetë gjykata ka detyrimin ta ngrejë edhe kryesisht, vlerësimin dhe vënien në bisedim, për të marrë edhe qëndrimin e palëve, lidhur me ekzistencën së kompetencës lëndore dhe funksionale për shqyrtimin e çështjes dhe të disponojë lidhur me to.

2. Ndërsa sipas pikës 2, të nenit 13 të Ligjit nr.49/2012, i ndryshuar, ngritja e pretendimit dhe e kundërshtimit mbi kompetencën tokësore të gjykatës administrative ku është paraqitur për shqyrtim padia, nuk vlerësohet e disponohet kryesisht nga gjykata, por mund të parashtrohet vetëm nga palët.

3. Ngritja e pretendimit dhe kundërshtimi i kompetencës tokësore mund të parashtrohet nga palët vetëm përpara se gjykata të ketë disponuar me vendim të ndërmjetëm fillimin e hetimit gjyqësor, debatin dhe shqyrtimin e provave.

Cështja nr.3

A mund të fitohet gjyqësisht grada policore për shkak të plotësimit të kriterit të vjetërsisë në gradë dhe/ose ushtrimit të funksionit përkatës për gradën e pretenduar, pa lu nënshtruar procedurës së vlerësimit konkurrues nga një komision gradimi ? (20 pikë)

Përgjigje:

1. Në mbështetje të Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, fitimi i gradës policore realizohet përmes një procedure administrative që kalon nëpër disa faza dhe kuadrohet nga detyrimi i kandidatëve për plotësimin e një sërë kriteresh formale. Procesi i dhënies së gradave policore, kushtëzohet, *së pari*, me plotësimin e kriterëve objektive për konkurrim, të cilat listohen në nenin 55 të këtij Ligji dhe, *së dyti*, me kalimin me sukses të procedurës konkurruese të testimit dhe kryerjes së trajnimeve përkatëse. Këto faza duhet të paraprihen nga ekzistenca e vendeve vakante për funksionet takuese, të cilat i korrespondojnë gradës, për të cilën zhvillohet konkurrimi. Ky proces formësohet nëpërmjet ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit të organit publik, në drejtim të çeljes dhe administrimit tërësor të procedurave konkurruese.

2. Bazuar në Ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, veçanërisht nenet 50-55 të tij, legjislatori synon rishikimin e rolit të gradave në Policinë e Shtetit, duke ribashkuar gradën me funksionin, e më pas funksionin me trajtimin financiar. Legjislatori e ka konceptuar gradën policore si një e drejtë që fitohet

nëpërmjet procesit vlerësues e konkurrues, duke i njohur kompetencën ekskluzive autoritetit përkatës, komisionit të gradimit, për zhvillimin e karrierës policore të punonjësve të policisë, përmes ecurisë në gradë. Ligji nr.108/2014 ka përcaktuar edhe organet e ngarkuara me kompetencën për dhënien e gradës në përfundim të procesit të konkurrimit. Ligji nr. 108/2014 njeh kompetencën ekskluzive dhe diskrecionare të komisionit të gradimit për vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në procesin konkurrues për fitimin e gradës.

3. Plotësimi i kriterëve formale për fitimin e gradës, të parashikuara në nenin 55 të Ligjit nr.108/2014, nuk përbën kushtin e vetëm për përfitimin e gradës policore. Ky Ligj, në nenet 55-59 ka parashikuar të gjitha hallkat e procedurës administrative për fitimin e gradave policore. Kriteret e parashikuara në nenin 55 të ligjit kanë natyrë objektive formale, plotësimi i të cilave verifikohet nga strukturat qendrore të burimeve njerëzore gjatë fazës së aplikimit, testimit, trajnimit, deri në momentin e fitimit të gradës. Këto kriterë përbëjnë vetëm kushtet formale që shoqërojnë aplikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë procedurave vlerësuese dhe konkurruese. Për fitimin e gradës policore punonjësit e Policisë së Shtetit duhet të kalojnë me sukses fazën e testimit me shkrim, intervistës me gojë dhe specifikuat për përfitimin e gradës “Kryekomisar” deri në “Drejtues i Parë” parashikohet edhe kryerja e ushtrimeve vlerësuese.

4. Gjykatat administrative gëzojnë pushtetin e kontrollit të kufijve ligjor të vendimmarrjes së autoriteteve publike. Në rastin e zbatimit të Ligjit nr.108/2014, juridiksioni gjyqësor në kontrollin e veprimtarisë administrative të organit publik në procesin e dhënies së gradave mund të shtrihet në drejtim të vlerësimit të gabuar ligjit, konstatimit të rrethanave të pasakta ose kryerjes së gabimeve procedurale të tilla që kanë ndikuar në vlerësimin e gabuar të përmbushjes së kriterëve formale për aplikimin në fazën e konkurrimit, duke përfshirë kundërshtimin e secilës prej fazave administrative për fitimin e gradës. Por, juridiksioni gjyqësor që gëzojnë gjykatat administrative në këtë proces nuk mund të zëvendësojë organin publik, konkretisht komisionin e gradimit, duke dhënë gjyqësisht gradën policore, në kushtet ku aplikanti nuk i është nënshtruar konkurrimit për fitimin e gradës.

5. Çdo vendimmarrje gjyqësore që detyron organin publik të njoh gradën policore punonjësve të policisë, pa lejuar zhvillimin sipas ligjit të një procedure administrative vlerësimi nga komisioni përkatës i gradimit, duke ushtruar në mënyrë të paligjshme kompetenca ekskluzive dhe ekzekutive të organit publik, në cenim të pushtetit të tij diskrecionar për të vlerësuar përmbushjen e të gjitha kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligj për fitimin e gradës, në thelb ka zëvendësuar funksionin që ka organi publik në këtë proces ligjor të rëndësishëm. Një qëndrim i tillë cenon rëndë parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe parimin e ligjshmërisë.

6. Fitimi i gradave policore gjyqësisht pa ju nënshtruar më parë punonjësit e policisë procedurës konkurruese cenon rëndë edhe parimin e shanseve të barabarta. Nëse fitimi i gradës do të realizohej vetëm nëpërmjet një vendimi gjyqësor, pa iu nënshtruar procedurave administrative të konkurrimit, atyre do t'u jepej mundësia i një vlerësimi tërësisht individual, të pakrahasueshëm me meritat dhe të drejtat e kandidatëve të tjerë, pikërisht duke cenuar rëndë gjykimin e barabartë mbi të gjithë kandidatët e tjerë që kanë apo do të kishin të drejtën e konkurrimit dhe të vlerësimit të meritave të tyre sipas ligjit.

7. Si përfundim, procesi i fitimit të gradave policore nga niveli “Nënkomisar” deri në nivelin “Drejtues i Parë”, duhet t'i nënshtrohet domosdoshmërisht procedurës së vlerësimit konkurrues, sipas parashikimeve të neneve 50-60 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Plotësimi i kriterëve formale për fitimin e gradës, si vjetërsia në gradën pararendëse dhe/ose ushtrimi efektiv i funksionit në përputhje me gradën e pretenduar, nuk mund të sjellin fitimin gjyqësisht të gradës policore, pa iu nënshtruar më parë punonjësit e Policisë së Shtetit një procesi vlerësimi konkurrues nga komisioni i gradimit.



Cështja nr.4

Deri ku shkon pushteti i gjykatës për të vlerësuar diskrecionin e organit administrativ që nuk i ka dhënë gradën policore ? (7 pikë)

Përgjigje:

1. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve qendrore, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese. Po kështu, asnjë institucion pushteti nuk mund të marrë përsipër kompetenca nga një institucion tjetër e as mund të transferojë ose të heq dorë prej tyre.

2. Autoriteti publik i organeve administrative ushtrohet përmes kompetencave urdhëruese ligjzbatuese, si edhe nëpërmjet kompetencave diskrecionare të dhëna me ligj. Pushteti diskrecional është pushteti që i jep një autoriteti administrativ një shkallë të caktuar lirie për të marrë vendime, duke i mundësuar që të zgjedhë mes disa vendimeve të pranueshme ligjore atë që është më i përshtatshëm. Parimi i ligjshmërisë, vendos kufijtë negativ të sjelljes së organit publik, duke e detyruar atë të veprojë në zbatim të kërkesave urdhëruese të ligjit. Nga ana tjetër, kompetenca diskrecionare e organit duhet të jetë e parashikuar në ligj, duke deleguar gjykimin autonom për kryerjen e zgjedhjeve alternative të caktuara, për të qenë në përputhje me parimin e ligjshmërisë. Në këtë kuptim, diskrecioni është ushtrimi i pushtetit të autorizuar nga ligji, por i kufizuar nga e drejta.

3. Shtrirja e kontrollit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative përfshin kontrollin e ligjshmërisë së veprimit administrativ dhe veprimtarisë administrative në tërësi, në drejtim të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit të organit publik, i cili garantohet përmes parimit kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Funksioni thelbësor i kontrollit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative, kryesisht synon të garantojë mungesën e arbitraritetit në ushtrimin e kompetencave administrative të organit publik. Në këtë drejtim, gjykata duhet të jetë e kujdesshme për të mos vepruar vetë si një organ administrativ, përveç rasteve kur një gjë e tillë parashikohet shprehimisht nga ligji.

4. Në rastin kur organi publik ka një pushtet diskrecionar ndërmjet disa zgjedhjeve, ligjshmëria e vendimmarrjes së tij mund të kontrollohet në gjykatë, por në rast se gjykata konkludon se vendimi është i paligjshëm nuk mund të vendosë vetë për thelbin. Gjykata ka të drejtën të rikthejë çështjen edhe njëherë para organit administrativ kompetent në mënyrë që ky i fundit të marrë një vendim të ri, brenda pushtetit të tij diskrecionar.

Cështja nr.5

Cila mendoni se është zgjidhja ligjore për mosmarrëveshjen juridike në gjykim ? Arsyejtoni vendimmarrjen (8 pikë)

Përgjigje:

1. Paditësit i është njohur grada "Komisar" me urdhrin nr. 3052/1, datë 02.11.2010 të Drejtorit të Policisë së Shtetit. Së fundi, me urdhrin nr. 452, datë 08.02.2016, të Drejtorit të Policisë së Shtetit paditësi është transferuar dhe emëruar në detyrën Shef Komisariati, në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër. Në muajin janar 2017, paditësi i është drejtuar palës së paditur me kërkesën për njohjen e gradës policore "Kryekomisar", me pretendimin se ka kaluar afati 3 vjeçar i qëndrimit në gradën policore "Komisar", pala e paditur nuk ka zhvilluar procedura konkurrimi për fitim të gradave policore, ndërkohë që ushtron funksion policor që in përgjigjet gradës "Kryekomisar". Pala e paditur përmes shkresës nr. 159/1 prot., datë 09.02.2017 ka refuzuar kërkesën e

paditësit për njohjen e gradës "Kryekomisar", për shkak se ligji nr. 108/2014 nuk parashikon marrjen e gradës sipas pozicionit të punës dhe se fitimi i gradës mundësohet vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes në proces konkurrimi, pas plotësimit të kriterëve të përcaktuara në ligj.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë me vendimin nr. 202, datë 05.04.2017 ka pranuar padinë, duke vlerësuar se paditësit i takon përfitimi i gradës, për shkak se plotëson kushtin e vjetërsisë në detyrë dhe efektivisht ushtron funksionin në përputhje me gradën e pretenduar "Kryekomisar". Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.1812, datë 26.04.2018.

3. Në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit të zbatueshëm mbi gjendjen e faktit që është vërtetuar në këtë gjykim, Gjykata vlerëson se plotësimi i kriterit të ushtrimit të funksionit të kërkuar për gradën e pretenduar dhe vjetërsisë në gradë, nuk mund të sjell përfitimin gjyqësisht të gradës policore të pretenduar, pa iu nënshtruar procedurës së konkurrimit vlerësues nga komisioni i gradimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 108/2014. Për rrjedhojë, pretendimet e paditësit se plotëson kushtet për fitimin e gradës dhe duhet ta fitoj atë gjyqësisht, pasi organi nuk ka hapur procedurën e konkurrimit, nuk gjejnë mbështetje në ligj.


4. Paditësi ka pasur mjete dhe rrugë të tjera për të kërkuar dhe kundërshtuar me anë të padisë ushtrimin e diskrecionit nga ana e palës së paditur në lidhje me administrimin dhe çeljen e proceseve të konkurrimit për fitimin e gradave policore, por jo duke pretenduar dhënien e menjëhershme të gradës nga gjykatat, në kushtet ku nuk është ndjekur procedura ligjore konkurruese për fitimin e gradës policore.

5. Për këto arsye, meqenëse zbatimi i ligjit procedural apo material nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes objekt gjykimi,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 63, shkronja "dh)", të Ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 1812, datë 26.04.2018 të Gjykatës Administrative e Apelit dhe vendimit nr. 202, datë 05.04.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe rrëzimin e padisë së paditësit L. N.



1997
GJYKATË ADMINISTRATIVE